



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Fier, më 28/06/2021

Lënda: Formulari i Njoftimit të Fituesit për procedurën me objekt **“Rikonstruksion i segmentit të rrugës Seman-bregdet dhe sheshit para Pallatit të Sportit Fier”**, me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë Fier

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

BASHKIA FIER

Për: Bashkimin e operatoreve ekonomike **“ GRAND KONSTRUKSION M ” SHPK & “ FLED ” SHPK**

Adresa: Fier Ballsh Lagjja 5 Shkurti .

* * *

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike.**

Numri i referencës së procedurës / lotit: **REF-97209-06-02-2021.**

1. Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i segmentit të rrugës Seman-bregdet dhe sheshit para Pallatit të Sportit Fier”**, me fond limit total prej **8 000 000 (tete milion) lekë pa TVSH** dhe me vlerë totale prej **9 600 000 (nëntë milion e gjashtëqind mijë) lekë me TVSH**, me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë Fier, në perputhje me Projektin, Preventivin dhe kushtet e përcaktuara në DST.
2. Afati kohor për ekzekutimin e punimeve: **4 (katër) javë .**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [7 Qershor 2021], [Numri 88].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët- **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“GRAND KONSTRUKSION M ”** SHPK me numer L38109801T& **“FLED”** SHPK, me numer K17621104C.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **6 000 017 lekë pa TVSH.**

2. Operatori ekonomik **“NIKA”** SHPK, numri i NUIS J76705047U

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **6 101 116,32 lekë pa TVSH.**

3. Operatori ekonomik **“BAJRAMI N”** SHPK, numri i NUIS K02727202O

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **6 529 660,41 lekë pa TVSH.**

4. Operatori ekonomik **“ZDRAVO”** SHPK, numri i NUIS J84003411K.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **7 218 165 lekë pa TVSH.**

5. Bashkimi i operatoreve ekonomikë **“SARK”** SHPK, numri i NUIS K52531415H

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **7 220 685 lekë pa TVSH.**

6. Operatori ekonomik **“B 93 II”** SHPK, numri i NUIS L52209050O.

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **7 595 733.6 lekë pa TVSH**

7. Operatori ekonomik **“AGBES KONSTRUKSION”** SHPK, numri i NUIS K32807432W

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **7 753 969.04 lekë pa TVSH**

8. Operatori ekonomik **“K.M.K”** SHPK, numri i NUIS L78223801E

Vlera totale sipas formularit te ofertes eshte **5 357 764 lekë pa TVSH**

Eshte skualifikuar ofertuesi i mëposhtëm:

1.Operatori ekonomik **“K.M.K”** SHPK, numri i NUIS **L78223801E.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. OE **“K.M.K”** shpk ka mungese dokumentacioni sa i takon përvojës së mëparshme të ngjashme, pasi nuk ka paraqitur te gjitha dokumentat e kerkuar ne piken 2.3.1, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 11 te DST.

Konkretisht, K.M.K. shpk per te provuar përvojën e mëparshme të ngjashme, ka paraqitur kontraten **“Rikonstruksion rruga Bisht Kamza”**, me AK Bashkia Durres. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur, rezulton se OE nuk ka paraqitur dokumentin **“Certifikaten e marrjes në dorëzim”**, per kete investim publik, sic kerkohet shprehimisht ne piken 2.3.1, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit. OE ofertues per kete kontrate publike, ka paraqitur Aktin e Kolaudimit te dates 11.10.2019, dhe bazuar ne kerkesen e percaktuar nga AK ne piken 2.3.1, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 11 te DST, bazuar edhe ne percaktimet ligjore te sanksionuara ne legjislacionin e ketij sektori, specifikisht në U.K.M. nr.2 dt.13.05.2005 *“Per zbatimin e punimeve te ndertimit”* , kreu II,

pika 10.2, ku percaktohet se "Objekti merret në dorëzim në datën e nënshkrimit të procesverbalit të kolaudimit", OE ofertues ka pasur detyrimin te paraqiste ne kete procedure "Certifikaten e marrjes në dorëzim", pas aktit te kolaudimit. Ne vend te saj, OE ofertues ka paraqitur dokumentin "Certifikata e perfundimit te punimeve" te dates 26.07.2019, dokument i cili ne vleresimin e KVO nuk zevendeson dokumentin e kerkuar ne DST.

2. OE "K.M.K." shpk nuk ka paraqitur dokumentacion te rregullt ne lidhje me kriterin per kualifikim "*Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në mjetet që nevojiten për ekzekutimin e kontratës*", te percaktuar ne piken 2.3.5, te rubrikes 2.Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Shtojca 11 te DST.

Konkretisht, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për mjetet që shënohen në regjistrat publikë (*me targë*), per te cilet Ofertuesi duhet ti shoqerorë gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, per mjetin "Autobitumatrice" me targë AA067UG, konstatohet se certifikata e paraqitur nga OE ofertues, e lëshuara nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar "**Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak**" ne emer te pronarit te mjetit, nderkohe qe, ky mjet eshte marr me qira nga OE ofertues, sic rezulton nga dokumentacioni i paraqitur ne tender dhe ne Shtojcen 10. Per me teper, sa i takon ligjshmerise se qarkullimit te ketij mjeti, kjo certifikate eshte me afat deri ne date 10.06.2021, nderkohe qe tenderi eshte me date 14.06.2021, pra eshte jashte afatit dhe vleresohet dokument jo i rregullt.

Dhënia me qira e ketij mjeti është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 "Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve" i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për "Transportet rrugore", si dhe në nenin 41, të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për "Transportet rrugore", ku parashikohet se: "Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse. Përsa cituam më lart paraqitja e dokumentacionit lidhur me këtë mjet do të konsiderohet i pasaktë dhe për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te mjeteve te paraqitura nga K.M.K.shpk, konstatohet se OE ofertues ka mungesa dhe mangesi sa i takon disponueshmerise se mjeteve te kerkuar ne DST: "Rrul ngjeshes me peshe operative mbi 15 ton" dhe "Rrul vibrues hekur-hekur asfalti mbi 9 ton".

Konkretisht, OE ofertues ne Shtojcen 10 "Mbi disponimin e makinerive" ka deklaruar disponimin me kontrate qiraje te mjetit "Rrul Vibrues Bitelli mbi 15 ton" dhe te mjetit "Rrul vibrues hekur – hekur 14 ton", sipas kontrates noteriale te qirase Nr. 2550 Rep Nr.570 Kol date 04.08.2020.

Nderkohe, ne dokumentin PDF te paraqitur ne SPE, "K.M.K_Rrul_vibrues_bitelli-Feba.pdf", konstatohet se kontrata noteriale e qirase Nr.2550 Rep Nr.570 Kol date 04.08.2020 ka bashkengjitur dokumentacion shoqerues zhdoganimi vetem per 1 (nje) rrul marka Mibio me kapacitet 7 ton (referuar akteve te zhdoganimit ky rrul rezulton me peshe 7.5 ton). OE K.M.K. shpk nuk ka paraqitur asnje dokument tjetër per te vertetuar disponimin e mjeteve

rrul sic ato kerkohen ne DST, sic ka deklaruar ne Shtojcen 10. Per me teper, edhe dokumentacioni qe ka paraqitur per rruhin marka Mibio, nuk ka tonazhin e kerkuar ne DST.

*** * ***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se bashkimi i operatoreve ekonomikë **“GRAND KONSTRUKSION M ” SHPK & “ FLED ” SHPK**, me adrese; Fier Ballsh Lagjja 5 Shkurti, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **6 000 017 lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni te lutur të paraqisni pranë **Njësisë së Prokurimit të Bashkisë Fier, Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”**, sigurimin e kontratës dhe të nëshkruani kontratën, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 97 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Shënim: Bashkimi i operatoreve ekonomike **“GRAND KONSTRUKSION M ” SHPK & “ FLED ” SHPK**” qe rezultoi fitues pas procedures se prokurimit do te dorezoje prane AK, para lidhjes se kontrates dokumentacionin si me poshte (ne perputhje me nenin 14, pika 2 te ligjit nr.162/2020):

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë **17.06.2021**.

Ankesa: ka ose jo,- **JO**.

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë:

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Armando SUBASHI